



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Shkurt 2022

Nr: 62

V E N D I M

P Ë R

**REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR NË BASHKINË SHKODËR TË
PROPOZUAR NGA “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, ZJ. MAJLINDA XHEVDET
ANGONI PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE TË
DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13 438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 67, pika 2, nenit 72, nenit 73, nenit 165, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” si dhe të vendimi nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e depozituar për regjistrim e kandidatit për kryetar bashkie për zgjedhjet e pjesshme vendore që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



Data: 11 Shkurt 2022
Nr. 62

“Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Shkodër të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zj. Majlinda Xhevdet Angoni për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13 438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie në Bashkinë Shkodër, Bashkinë Dibër, Bashkinë Durrës, Bashkinë Vorë, Bashkinë Rrogozhinë dhe Bashkinë Lushnjë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 32, datë 2.2.2022, “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë Socialiste të Shqipërisë për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, ka regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me kryetar z. Edi Rama.

Në zbatim të pikës 2, të vendimit nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka depozituar në KQZ kërkesën për regjistrimin e zj. Majlinda Xhevdet Angoni, si kandidat për kryetar në bashkinë Shkodër.

Në bazë të nenit 67, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve regjistron kandidatët për kryetar në bashkinë Shkodër, pasi bashkia Shkodër, nuk administrohet nga një KZAZ e vetme.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës si më poshtë listuar:

1. Kërkesë e partisë politike, për regjistrimin e kandidat për kryetar, në bashkinë Shkodër.
2. Kopje të dokumentit të identifikimit të kandidatit për kryetar bashkie.
3. Deklarimi i llogarisë bankare të posaçme të kandidatit, sipas Model 03/1 të Udhëzimit.
4. Deklarata e kandidatit ku deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat “b”e“c”, të nenit 72, të Kodit Zgjedhor, sipas Model 05.
5. Kopje e deklaratës së dorëheqjes të kandidatit për kryetar në bashkinë Shkodër zj. Majlinda Xhevdet Angoni, nga funksioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, drejtuar z. Bledi Çuçi.
6. 20 (njëzet) vërtetime të Kuvendit të Republikës, nëpërmjet së cilave vërtetohet zotërimi i mandateve nga deputetë të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".
7. Jetëshkrimi i kandidatit për kryetar bashkie, sipas Model 07 të Udhëzimit.
8. Formulari e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Shkodër zj. Majlinda Xhevdet Angoni, me nr. 7 unik, datë 8.2.2022.
9. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave, sipas Model 08 të Udhëzimit.



Zj. Majlinda Xhevdet Angoni, në përputhje me parashikimet e nenit 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i kryetarit të bashkisë.

Nga verifikimi prima facie i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Shkodër, Qarku Shkodër, zj. Majlinda Xhevdet Angoni, rezulton se: Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitetet e mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga “Jubani” në “Angoni”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 616 prot., datë 08.02.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 615 prot., datë 08.02.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar bashkie në bashkinë Shkodër, Qarku Shkodër, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për kryetar në bashkinë Shkodër, Qarku Shkodër, zj. Majlinda Xhevdet Angoni.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 1491/1 prot., datë 10.02.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar në bashkinë Shkodër, Qarku Shkodër, zj. Majlinda Xhevdet Angoni, e cila rezulton se nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë, është e padënuar.

Referuar ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për kryetar në bashkinë Shkodër, Qarku Shkodër, zj. Majlinda Xhevdet Angoni, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 11.2.2022, verifikoi dokumentacionin e kandidatit për kryetar në bashkinë Shkodër, të depozituar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pika 2, nenin 72, 165, pika 1 dhe 173 të Kodit Zgjedhor.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 67, pika 2, nenit 72, nenit 73, nenit 165, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” si dhe të vendimi nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”

VENDOSI:

1. Të regjistrojë si kandidat për kryetar në bashkinë Shkodër, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, zj. Majlinda Xhevdet Angoni të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga data e shpalljes të këtij vendimi, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

